



Democracy for Development
Demokraci për Zhvillim
Demokratija za razvoj

Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?

**Analizë e punës së
Komisionit për ndryshime zgjedhore
dhe
vlerësim i amendamenteve të para**

Prishtinë
Mars 2012



PËRMBAJTJE

HYRJE	4
REFORMË SA PËR ADET	4
MARRËVESHJA DHE REZOLUTA PËR DALJE NGA KRIZA	5
QASJA DHE AMBICIA MODESTE	6
NËNKONTRAKTIMI I DEMOKRACISË	7
ARNIMI NË VEND TË KODIT ZGJEDHOR	8
150 REKOMANDIME DYTËSORE	9
PËRGJIGJA NDAJ PROBLEMEVE	10
PËRFUNDIMET DHE SUGJERIMET	19

www.d4d-ks.org

Copyright © 2012. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të D4D.

Ky publikim është mundësuar me përkrahjen e Departamentit Federal për Punë të Jashtme të Zvicrës.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të D4D-së.

Hyrje

Pas gati një viti punë, Komisioni parlamentar për reformë zgjedhore pritet që në javët në vijim të arrijë me një draft-ligj për zgjedhje të përgjithshme. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) ka bërë një analizë rekomandimeve të nxjerra nga Komisioni dhe Grupi Punues për Reformë Zgjedhore. D4D ka analizuar se në çfarë shkalle janë marrë parasysh vlerësimet e bëra nga organizatat ndërkombëtare të cilat i kanë vlerësuar zgjedhjet e kaluara dhe kanë dhënë rekomandime të ndryshme. Bazuar në punën që është bërë deri më tani dhe kohën që ka mbetur në dispozicion është pak e pritshme që ligji i ri të ngushtojë hapësirën për keqpërdorime.

Krijimi i një grupi të jashtëm punues e ndërlikoi procesin e reformës zgjedhore. Vendimmarrja u bart nga komisioni që përbëhet vetëm nga deputetët tek një grup më i gjerë që defaktorizoi Kuvendin. Përderisa bashkësia ndërkombëtare harmonizonte qëndrimet, në komision vuloseshin rekomandimet.

Komisioni lavdërohet se sukseset kryesore janë ulja e fushatës nga 30 në 20 ditë dhe heqja e obliguar e posterëve. Një përparim tjetër kryesor është mundësia e vëzhguesve për të qëndruar/ulur prapa komisionerëve. Por nuk është punuar as përafërsisht sa duhet në listë të votuesve, disiplinë të komisionerëve, apo në ndryshime ligjore që rrisin mundësitë për identifikim dhe dënim të manipuluesve.

Me këtë analizë, D4D insiston për një proces që kthen dinjitetin e zgjedhjeve. Nëse komisioni përfundon punën pa mbyllur hapësirën për keqpërdorime, atëherë me të vërtetë mund të thuhet se është bërë reformë sa për adet.

Reformë sa për adet

Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i përgjithshëm i reformës zgjedhore që Kosova ka ndërmarrë pas zgjedhjeve të vitit 2010. Komisioni për reformë zgjedhore ka hyrë në fazën finale të punës së tij dhe ka përgatitur një pako rekomandimesh të cilat i janë dhënë një grupi draftues për të hartuar një ligj të ri. Punimi vlerëson procesin e rishikimit të ligjit, punën e Komisionit dhe të institucioneve tjera të përfshira, si dhe amendamentet të cilat kanë rezultuar nga ky proces.

Janë përgatitur 150 rekomandime por pak prej tyre sjellin përmirësime reale. Nëse nuk shfrytëzohen këto javë që kanë mbetur në dispozicion për të bërë disa ndryshime esenciale në aspekt të organizimit të procesit zgjedhor, atëherë nuk ka arsye të pritet ulja e keqpërdorimeve. Ashtu siç është tash, reforma është vetëm makijazh që fsheh por nuk trajton rrudhat e zgjedhjeve. Nëse krahas reformës së vakët, do të kemi disa palë zgjedhesh në një ditë siç edhe pritet, atëherë shkalla e keqpërdorimit të zgjedhjeve vetëm sa do të rritet.

Disa nga pyetjet të cilat shtynë këtë punim janë: A ka arritur ky komision që të përmbushë mandatin e vet? A garantojnë rekomandimet e ofruara nga ky komision një proces më të mirë? A janë trajtuar me seriozitet temat që ndikojnë drejtpërsëdrejti në procesin zgjedhor? Çfarë roli ka pasur bashkësia ndërkombëtare? Si filloi reforma dhe ku jemi tani?

- ⇒ **A ka arritur ky komision që të përmbushë mandatin e vet?**
- ⇒ **A garantojnë rekomandimet e ofruara nga ky komision një proces më të mirë?**
- ⇒ **A janë trajtuar me seriozitet temat që ndikojnë drejtpërsëdrejti në procesin zgjedhor?**
- ⇒ **Çfarë roli ka pasur bashkësia ndërkombëtare?**
- ⇒ **Si filloi reforma dhe ku jemi tani?**

Problemet kryesore të zgjedhjeve të kaluara nuk janë trajtuar si duhet, përfshirë temat kryesore të cilat mbajnë peng tërë procesin. Tri kategori kryesore të çështjeve që nuk janë përfunduar si duhet janë:

- (a) temat sistemore, pa përcaktimin e të cilave nuk mund të diskutohen çështjet teknike;
- (b) ankesat/parashtresat dhe gjobat e dënimit;
- (c) procesi zgjedhor që ka lejuar keqpërdorime masive.


Mosmarrja e vendimeve për sistemin zgjedhor ka ngritur shqetësime të ndryshme nga partitë më të vogla politike dhe nga shoqëria civile. Shpesh pretendohet se kjo shtyrje në marrjen e vendimeve për çështjet madhore mund të jetë e qëllimshme për dy arsye:

- (a) për të lënë më pak kohë për riparimin e administrimit të zgjedhjeve dhe parandalimin e keqpërdorimeve; dhe
- (b) shmangies së subjekteve politike nga shndërrimi në cak në rast të zgjedhjes së një sistemi me pak përkrahje publike.

Dënimet dhe procesi janë gjithashtu tejet të rëndësishme sepse janë thelbësore për parandalimin e keqpërdorimeve. Duhet rikujtuar se në sytë e publikut reforma është perceptuar si mënyrë për të parandaluar keqpërdorimet si dhe për t'i ikur bllokimit të institucioneve siç ndodhi pas zgjedhjeve më 2010.

Marrëveshja dhe rezoluta për dalje nga kriza

Vendi u fut në krizë institucionale pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese (28 mars 2011) se votimi i Kuvendit për Presidentin ishte jo-kushtetues. Ndërmjetësimi i faktorit ndërkombëtar pajtoi liderët e tri partive (PDK, LDK dhe AKR) me një marrëveshje për tejkalimin e kësaj krize që u arrit më 6 prill. Një ditë pas, marrëveshja u votua si rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Nënshkrimet e palëve të marrëveshjes politike.

Marrëveshja dhe rezoluta e Kuvendit përkrahën:

- ⇒ Zgjedhjen e Atifete Jahjagës për President;
- ⇒ Formimin e një Komisioni për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale¹;
- ⇒ Formimin e një Komisioni për Reformën e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme²;
- ⇒ Mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme jo më vonë se 18 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve zgjedhore dhe kushtetuese³.

¹ Tani në Kuvend, ky komision quhet „Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

² Tani në Kuvend ky komision quhet „Komisioni për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës”.

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës. 07 prill 2011. Rezolutë në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behxhet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi. f: 1.

Komisionit për ndryshim kushtetues iu dha mandat të hartojë ndryshimet e nevojshme kushtetuese ashtu që Presidenti i vendit të zgjedhet drejtpërdrejtë nga populli si dhe të harmonizojë ligjet tjera nëse ndikohen nga reforma kushtetuese. Komisioni për ndryshimin e ligjit për zgjedhjet mori mandat që në mes tjerash të bëjë ndryshimet e duhura për të siguruar krijimin e zonave zgjedhore. Komisioni i parë ju besua një deputeti të pozitës dhe iu dha afat prej 6-9 muaj për përfundimin e punës. Komisioni tjetër ju besua një deputeti të opozitës me afat prej 8-12 muaj.

Gjykuar nga teksti i marrëveshjes dhe i rezolutës, reforma nuk u nis për shkak të shkeljeve të shumta, por për të zhblllokuar ngërçin politik.

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në vazhdimësi e ka përcjellë punën e të dy komisioneve, veçanërisht atij për reformë zgjedhore. Së bashku me OJQ tjera të bashkuara nën ombrellën e Forumit Reforma, D4D ka ofruar rekomandimet e veta për disa nga çështjet kryesore që kanë qenë nën shqyrtim nga të dy komisionet.

Ambicia modeste

Edhe pse nuk rekomandohet ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit zgjedhor, Kosova ka bërë ndryshime pothuajse para çdo cikli të zgjedhjeve. Fatkeqësisht, këto reforma asnjëherë nuk kanë qenë të mirëfillta dhe nuk i kanë trajtuar çështjet më thelbësore. Shija e hidhur dhe imazhi i dëmtuar rëndë në zgjedhjet e fundit, u duk se alarmuan opozitën dhe vetëdijesuan palët tjera të interesuara për domosdoshmërinë për një reformë të mirëfilltë zgjedhore. Sidoqoftë, përkundër optimizmit të madh, reforma që në fillim u pa se nuk ishte e sigurtë.

Gjykuar nga teksti i marrëveshjes dhe i rezolutës, reforma nuk u nis për shkak të shkeljeve të shumta, por për të zhblllokuar ngërçin politik. As marrëveshja politike në mes të liderëve të tri subjekteve politike dhe as Rezoluta e Kuvendit të Kosovës nuk referohen në procesin e dëmtuar zgjedhor. Përveç që deformuan vullnetin e qytetarëve, tri palë zgjedhjet e kaluara dëmtuan rëndë edhe imazhin e Kosovës në botën e jashtme. Këto dy dokumente në mënyrë eksplicite përmendin vetëm krijimin e zonave dhe keqpërdorimet mund të gjenden vetëm nëse kështu mund të interpretojmë duke lexuar kreativisht në mes rreshtave kur thuhet “mes tjerash”.

Duhet bërë dallimin e dy çështjeve që shpesh publiku Kosovar nuk e bënë, sistemit zgjedhor dhe administrimit si dy tema të veçanta. Krijimi i zonave zgjedhore është një kërkesë e kamotshme e shoqërisë civile, por parregullsitë nuk kanë ardhur si rezultat i sistemit apo i

“Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet ... për amendamentin e ... Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme ... që mes tjerash do të përkrahin krijimin e me shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë”.

mungesës së zonave dhe as nuk do të zgjidhen me krijimin e tyre. Krijohet perceptimi se sistemi zgjedhor është fajtori kryesor për parregullsitë në zgjedhjet e kaluara gjë që nuk është e vërtetë. Madje përhapet frika se liderët e partive dëshirojnë që këtë logjikë ta shpijnë aq larg sa të mbyllin listat.

Përfaqësimi gjeografik dhe zonat zgjedhore janë të rëndësishme por jo aq sa të dominojnë diskursin publik në llogari të luftimit të keqpërdorimeve. Ndonjëherë krijohet përshtypja se ky është problemi kryesor që duhet diskutuar dhe se nuk kemi probleme tjera. U bënë apo jo, zonat përmirësojnë përfaqësimin dhe

nuk trajtojnë keqpërdorimet.

Manipulimet janë bërë më të lehta për shkak të mangësive të administrimit të zgjedhjeve (qoftë për shkak të ligjit apo zbatimit të tij) si dhe të mungesës së vullnetit politik për të parandaluar ato. Do të ishte e udhës që Rezoluta e Kuvendit të Kosovës të merrej me:

- ⇒ Trajtimin e shkeljeve zgjedhore me prioritet nga Gjykatat dhe që manipuluesit e votave të marrin dënimin e merituar;
- ⇒ Përkushtimin që ligji i ri të jetë rigoroz dhe të zvogëlojë boshllëkun ligjor që mundëson shkeljet; dhe
- ⇒ Ndryshimin e dy tipareve kryesore në sistem zgjedhor, krijimin e zonave zgjedhore dhe votimin për një kandidat të vetëm.

Krijimi i zonave zgjedhore është një kërkesë e kamotshme e shoqërisë civile por parregullsitë në procesin zgjedhor nuk kanë ardhur si rezultat i sistemit zgjedhor apo i mungesës së zonave dhe as nuk do të zgjidhen me krijimin e tyre.

Fatkeqësisht, asnjëra nga dy pikat e para nuk përmenden në rezolutën e Kuvendit të Kosovës. Si rezultat i mos-efikasitetit të gjykatave të vendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akoma nuk e ka përmbyllur ciklin e kaluar zgjedhor, dhe do të dëmtojë hyrjen në cikël të ri zgjedhor. KQZ akoma nuk ka të drejtë të shkatërrojë një pjesë të madhe të materialit zgjedhor nga zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2010 për shkak të kontesteve të mbetura gjyqësore.

Krahas mostrajtitimit të keqpërdorimeve, komisioni nuk arriti të pajtojë qëndrimet e ndryshme për zonat, edhe pse kjo ishte detyra e vetme specifike që iu besua nga rezoluta. Komisioni shprehu mungesën e fuqisë së vet për të vendosur dhe ia la përfaqësimin gjeografik liderëve në nivel më të lartë, të cilët me sa dihet nuk janë takuar për këtë pikë.

Një vendim për sistemin (zonat, pragun, listat) duhet marrë në fillim si vendim parimor sepse ndikon në gjetjen e formulave adekuate për administrimin e zgjedhjeve. Për shembull, nuk mund të bisedohet nëse numërimi duhet të bëhet në vendvotim apo të centralizohet pa marrë vendim nëse do të ketë zona apo nëse hiqet vota preferenciale për pesë kandidatë. Madje shpesh ngrihen dilema se ky vendim është marrë por nuk bëhet publik për t'iu ikur kritikave të hershme. Kjo tregon për një proces të mbyllur dhe dëshmon që vendimmarrja për çështje madhore në Kosovë akoma është e koncentruar tek një numër i vogël i individëve, vendorë dhe ndërkombëtarë.

Nënkontraktimi i demokracisë

Në fillim të pranverës, bashkësia ndërkombëtare kishte formuar një grup punues të përbërë vetëm nga organizata ndërkombëtare, për të kërkuar sistemin zgjedhor që i duhet Kosovës. Pas marrëveshjes politike tre-palëshe, formohet Komisioni për reformë zgjedhore. Komisioni fillon punën e vet me disa muaj vonesë, për shkak se grupi parlamentar i PDK-së nuk kishte vendosur për përfaqësuesin e vet⁴. Pas formimit të komisionit, bashkësia ndërkombëtare ndryshon strategjinë dhe bindë komisionin që për shkak të mungesës së ekspertizës, të formojë një grup të jashtëm punues.

Grupi Punues për Reformë Zgjedhore u themelua më 5 korrik 2011. Grupi Punues ka bërë një punë të madhe në identifikimin e problemeve të procesit zgjedhor nga e kaluara. Janë vizituar shumë vende me përvojë në organizim të zgjedhjeve dhe është punuar më shumë jashtë vendit sesa brenda. Me koordinim të OSBE-së dhe më përkrahje të kohëpaskohshme të IFES dhe institucioneve tjera ndërkombëtare, Grupi Punues është marrë me shumë çështje të rëndësishme si dhe teknike. Grupi Punues nuk ka shqyrtuar propozimet që realisht do të ndikonin në mbylljen e hapësirave për keqpërdorim të procesit

Përfshirja e aktorëve tjerë në një proces gjithëpërfshirës është pozitive, por jo me koston e defaktorizimit të deputetëve.

⁴ Kosova Sot. 11 maj 2011. Konstituohet Komisioni për reformën zgjedhore. I qasshëm në: <http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/konstituohet-komisioni-per-reformen-zgjedhore> (qasur për herë të fundit me 06 mars 2012).

zgjedhor. Rrjedhimisht, rekomandimet e ofruara nuk ofrojnë siguri më të madhe se procesi zgjedhor nuk do të manipulohet.

Krahas anëtarëve të komisionit për reformë zgjedhore, grupi mbledh edhe pjesëmarrës nga: KQZ, Presidenca, PZAP-it, Ambasada Amerikane, Ambasada Britanike, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, Zyra Civile Ndërkombëtare, Instituti Demokratik Kombëtar, kryesuesit e grupeve jo formale të grave deputete dhe deputetëve të rinj, si dhe dy organizata jo-qeveritare, Instituti Demokratik i Kosovës (në emër të Demokracisë në Veprim) dhe KIPRED. Grupi koordinohet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe u bashkë-kryesua nga Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Përfshirja e aktorëve tjerë në një proces gjithëpërfshirës është pozitive, por jo me koston e defaktorizimit të deputetëve. Krijimi i një grupi të tillë punues kishte për pasojë edhe zhvendosjen e vendimmarrjes. Anëtarët e komisionit u bënë mysafir dhe humbën kontrollin e procesit, dhe vendimet filluan të merreshin gjetiu. Organizatat eksperte kanë pasur mundësi të ofrojnë ekspertizën e vet në kuadër të komisionit, por ndodhi që ata morën timonin dhe deputetët mbetën pasagjerë.

Më shumë çon peshë procesi ku harmonizohen qëndrimet, ballafaqohen kundërshtimet dhe nxjerrët kompromisi sesa vendi ku nënshkruhet vendimi.

Kryesimi i këtij grupi nga Kryetarja e KQZ-së ra ndesh me raportin e BE-së i cili kritikoi KQZ-në për rolin e tepruar në hartim të legjislacionit dytësor. Tani ishte vetë BE që u bë anëtar në këtë grup punues ku Kryesuesja e KQZ-së fitoi rol në hartim të ligjit si legjislacion primar. Këtu Kryetarja e KQZ-së vihet në rol qendror, përderisa anëtarët tjerë të KQZ-së ndjehen të anashkaluar dhe nuk kanë as qasje në të dhëna që duhet të jenë publike⁵.

Shpesh thuhet se grupi punues nuk ka marrë vendime por vetëm ka diskutuar, por vendimet nuk merren në momentin e nënshkrimit të tyre. Më shumë çon peshë procesi ku harmonizohen qëndrimet, ballafaqohen kundërshtimet dhe nxjerrët kompromisi sesa vendi ku nënshkruhen ato. Këto të gjitha janë bërë në grup punues dhe në komision vetëm sa është hedhur për votë formale. Jo vetëm që është bartur vendimmarrja tek agjendat tjera, por është krijuar një konfuzion, kemi konflikt interesi, është shpërqendruar llogaridhënia – përfundimisht, është nënkontraktuar demokracia.

Arnimi në vend të kodit zgjedhor

Vetë emri i komisionit zbulon se pikënisja nuk ka qenë kërkesa për ligj të ri, por për ndryshim të ligjit të vjetër. Hartimin e këtyre ndryshimeve e mori përsipër grupi draftues, i përbërë nga tre ndërkombëtarë dhe vetëm një jurist vendor. Udhëzimet për grupin draftues ishin tejet të përgjithësuara që reflektojnë në radhë të parë ambiciet e ulëta për reforma që ka pasur grupi dhe së dyti shkallën e ulët të pajtimit që anëtarët kanë arritur mes vete. Si rezultat, grupit draftues i ka dalë shumë punë të draftojë në bazë të rekomandimeve të paqarta dhe shpesh i duhet t'i japë kahe pikave kontestuese për të cilat komisioni nuk është pajtuar.

U desh që komisioni të marrë draftin e parë të ligjit të ri nga grupi draftues për të arritur në konkludim që amendamentet e paraqitura tejkalojnë 40% e ligjit aktual prandaj duhet të shkohet me ligj të ri. Nëse kësaj i shtohet edhe nevoja për ndryshime shumë më të mëdha si dhe përfshirje të shumë rregullave zgjedhore siç është rekomanduar, ligji do të pësojë ndryshime të ndjeshme. Këto ndryshime shpiten tek konkludimi se duhet një Kod gjithëpërfshirës zgjedhor dhe se është më mirë vonë se fare mos të kemi një reformë rrënjësore dhe t'u ikim arnimeve.

⁵ KQZ. 29 shkurt 2012. Nga takimi i pestë i mbledhjes së KQZ-së për vitin 2012.

150 rekomandime dytësore

Pas një pune të gjatë të Grupit Punues, në shkurt të vitit 2012, Komisioni miratoi 150 rekomandime për ndryshim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të cilat ju besuan grupit hartues. Në parim, rekomandimet e një grupi të tillë reflektojnë emëruesin më të vogël të përbashkët të një grupi të gjerë politik dhe të shumë organizatave të huaja.

Përparimi kryesor që është arritur është mundësia e vëzhguesve për të qëndruar/ulur prapa komisionerëve që përmirëson mundësinë për të vëzhguar. Komisioni dhe Grupi Punues kanë shpenzuar pak kohë në ndryshimin e neneve që mund të mbyllin hapësirat për manipulime. Nuk është punuar as përafërsisht sa duhet në listë të votuesve, identifikim të votuesve, disiplinë të komisionerëve, apo në ndryshime ligjore që rrisin mundësitë për identifikim më të lehtë të manipuluesve. Siç është koordinuar puna me Komisionin për Kushtetutë, duhet të bashkërenduar puna për ashpërsim të dënimeve për manipuluesit në Kodin penal. Degradimi kryesor është heqja e dënimeve kolektive që mund të shtyjë partitë të inkurajojnë ithtarët e tyre në dëmtim të procesit, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore.

Përgjigja ndaj problemeve

Për të vlerësuar ndryshimet e propozuara, D4D ka marrë si barometër shkallën e marrjes parasysh të sugjerimeve nga NDI, ENEMO, EU EEM që vënë në pah mangësitë e procesit zgjedhor. Në fillim të punës, grupi punues ka shqyrtuar komentet në fjalë gjatë identifikimit të problemeve si pjesë e veçantë e agjendës së punës së tyre. Në tabelat në vijim, D4D vlerëson shkallën e përmbushjes së këtyre sugjerimeve – në kolonën e majtë gjendet sugjerimi dhe në kolonën e djathtë paraqiten vlerësimet dhe komentet tona.

Sistemi zgjedhor

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
<p><u>Disa zona zgjedhore</u> me shumë kandidatë ka mundësi që të përmirësojë lidhjen në mes të Kuvendit dhe Elektoratit (EU EEM, NDI)</p>	<p>Përderisa sistemi zgjedhor ka qenë një ndër temat e para që ka diskutuar Komisioni për reformë zgjedhore, debati është bllokuar. Vetë rezoluta e Kuvendit dhe marrëveshja i ka jep këtij komisioni kompetencë për të marrë vendim për zonat, por komisioni lehtësisht shfajësoi veten duke i hedhur përgjegjësinë liderëve më lartë dhe nuk bëri mjaft për të arritur konsensus. Mosmarrja e këtij vendimi ka penguar marrjen e shumë vendimeve tjera për çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e zgjedhjeve.</p> <p>Statusi: E papërfunduar</p> <p>Ka rrezik që mos të krijohen zonat fare dhe ka tentativë për të mbyllur listat. Kjo çështje kërkon debat të gjerë dhe konsensus shoqëror dhe mosdeklarimi i subjekteve kufizon arsyeshmërinë për debat publik. Ka pasur propozime të ndryshme nga shoqëria civile duke përfshirë këtu Institutin D4D që së bashku me Forumin Reforma kanë dalë me propozimin për shtatë zona zgjedhore, me vende kompenzuese në një sistem proporcional.</p>
<p>Të thjeshtësohet sistemi zgjedhor (EU EEM)</p>	<p>Thjeshtësia që kërkohet varet nga ndryshimet në sistem të cilat nuk janë përfunduar. Numri i zonave, numri i votave preferenciale, listat e hapura dhe pragu janë përcaktuese në këtë aspekt.</p> <p>Statusi: E papërfunduar. Me tendencë të mbetet si është.</p> <p>Mënyra më e përfolur e thjeshtësimit është mbyllja e listave që do të paraqiste degradim të sistemit zgjedhor. D4D sugjeron thjeshtësim duke hequr votën preferenciale (shih pikën e ardhme).</p>
<p>Votuesi të votojë vetëm për <u>një kandidat</u> (EU EEM)</p>	<p>Heqja e votës preferenciale do të ndikonte tej mase në uljen e keqpërdorimeve, veçanërisht të atyre brenda subjekteve. Subjektet që preferojnë një zonë zgjedhore kërkojnë ruajtjen e votës preferenciale.</p> <p>Statusi: E papërfunduar</p>

	Instituti D4D dhe Forumi ‘Reforma’ ka përkrahur rekomandimin që të hiqet vota preferenciale dhe të reduktohet vota në vetëm një shenjë (☑) për kandidatin e preferuar.
Duhet të merret parasysh ulja e <u>pragut zgjedhor</u> prej 5% në mënyrë që të rritet gjithëpërfshirja e Kuvendit të Kosovës. Në lidhje me këtë, një prag prej 2 apo 3% duket më i përshtatshëm. (EU EEM)	Shumica e anëtarëve të komisionit janë pajtuar që pragu zgjedhor të ulet (me propozime nga 1% deri në 5%) por nuk është arritur konsensus. Si pjesë e sistemit, i është lënë udhëheqësve të partive. Statusi: E papërfunduar D4D dhe Forumi ‘Reforma’ ka përkrahur uljen e pragut në 3% dhe mos të vlejë për kandidatë të pavarur.
Kërkesat që dalin nga <u>kuota gjinore</u> mund të mos garantojnë pasqyrimin e drejtë të vullnetit të votuesve (ENEMO) Kthimi në lista të mbyllura të kandidatëve dhe garantimi që përafërsisht <u>30% e kandidatëve të zgjedhur të jenë gra</u> ; kjo do të kërkonte ndryshimin e Kushtetutës; ose Të mbahet lista e hapur, siç kërkohet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Status dhe në Kushtetutë dhe të lejohet që votuesi të shënojë vetëm një preferencë për një kandidat në fletëvotimin e tij/saj. (EU EEM) Mund të vendosen <u>mekanizma për të ruajtur kuotën brenda sistemit</u> me shumë zona zgjedhore, mekanizma të cilat duhet të hulumtohen (NDI)	Sipas EU EEM, kuota gjinore është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me listat e hapura dhe duhet zgjedhur njërën apo tjetrën. Kjo nuk është përkrahur nga Komisioni pasi që të dy këto tipare janë konsideruar arritje të mira të sistemit zgjedhor të Kosovës. Komisioni ka shprehur vullnetin që të ruajë kuotën gjinore edhe nëse Kosova formon disa zona zgjedhore, siç ka rekomanduar edhe NDI. Statusi: Me të drejtë e patrajtuar. D4D pajtohet me Komisionin për injorimin e këtij komenti si joadekuate për rrethanat kosovare. D4D e përkrah ruajtjen e kuotës gjinore me çdo kusht (me apo pa zona), por e refuzon argumentin se duhet sakrifikuar listat e hapura si parim jokompatibil me kuotën. Ka modele që arrijnë të dy objektivat por janë më të ndërlikuara dhe shkelin parimin e thjeshtësisë të theksuar më lartë. Një qartësim më i detajuar i mbajtjes së kuotës gjinore në kuadër të zonave është dhënë nga rekomandimet e paraqitura nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) së bashku me Forumin Reforma.

Partitë që përfaqësojnë pakicat

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
Duhet të merret në konsideratë heqja e kërkesës për <u>deklarimin e përkatësisë etnike</u> . (EU EEM)	Kjo çështje nuk është diskutuar fare nga Komisioni për reformë zgjedhore mbase edhe për arsye se Kushtetuta e Kosovës siguron mandate për pakica në Kuvendin e Kosovës që e bën të domosdoshëm deklarimin e subjekteve që garojnë për vende të rezervuara. Statusi: Me të drejtë e patrajtuar

<p>Duhet të merret në konsideratë qartësimi i mundësive për <u>koalicionet në mes partive të shumicës dhe komuniteteve jo-shumicë</u>. (ENEMO)</p>	<p>Kërkesa për këtë qartësim është me vend sepse mund të kemi situatë ku një koalicion ndër-etnik garon për vende të rezervuara të cilat në fund mund tu ipen deputetëve nga shumica.</p> <p>Statusi: E patrajtuar</p> <p>Ky është një problem që zvogëlon interesin për bashkëpunim, por përndryshe vendet e rezervuara apo të garantuara humbin kuptimin.</p>
--	--

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ)

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
<p><u>Përbërja e KQZ-së</u> mund të pasurohet me përfshirjen e disa gjyqtarëve si anëtarë të saj (ENEMO)</p>	<p>Komisioni nuk ka shqyrtuar mundësinë e futjes së ndonjë gjykatësi tjetër në KQZ që do të neutralizonte sadopak politizimin e KQZ-së. Komisioni ka dërguar dy propozime për përbërjen e KQZ-së, por asnjëra nga vendimet nuk parasheh shtimin e gjyqtarëve.</p> <p>Statusi: E patrajtuar</p> <p>Instituti D4D ka propozuar rritjen e numrit të anëtarëve të KQZ-së për të balancuar përbërjen në mes të pozitës dhe opozitës si dhe ka rekomanduar shtimin e një gjykatësi si zëvendës-kryesues kur mungon Kryesuesi i KQZ-së.</p>
<p>Ligji duhet të ndryshohet në mënyrë që të përfshijë dispozitat kryesore të cilat momentalisht rregullohen nga <u>rregullat e KQZ-së</u> (EU EEM & ENEMO)</p> <p>Dhënia e <u>fuqive të veçanta KQZ-së</u> për rregullimin e procesit zgjedhor është diskutabile, duke pasur parasysh përbërjen e politizuar të KQZ-së (ENEMO)</p>	<p>Përfshirja e rregullave zgjedhore të KQZ-së në ligj është marrë në konsideratë dhe disa pjesë të rregullave zgjedhore janë përfshirë në draft-amendamentet. Mirëpo, komisioni duhet të shqyrtojë të gjitha rregullat e KQZ-së dhe të vlerësojë se cilat duhet të inkorporohen në ligj pasi që KQZ deri tash ka marrë një rol legjislativ me disa rregulla zgjedhore.</p> <p>Statusi: Pjesërisht e përfunduar.</p> <p>D4D përkrah hartimin e një kodi zgjedhor gjithëpërfshirës që përfshin pjesën më të madhe të rregullave në ligj. Duke e pasur parasysh politizimin e KQZ-së, një ligj i detajuar është i domosdoshëm.</p>
<p>Përbërja e politizuar e KQZ-së mund të shihet si problematike kur kemi parasysh përgjegjësinë e KQZ-së për <u>përsëritjen e votimit në një qendër votimi</u> apo në një komunë (ENEMO)</p>	<p>Sa i përket marrjes së vendimit për përsëritje të votimeve Komisioni për reformë zgjedhor ka marrë vendim të qëlluar. Vendimmarrja për përsëritje i është lënë si kompetencë vetëm Gjykatës Supreme. Gjithashtu është precizuar edhe një normë për anulimin e rezultateve në një komunë të tërë nëse 35% të vendvotimeve janë manipuluar.</p> <p>Statusi: E trajtuar si duhet.</p>
<p>Rregulla të përgjithshme të punës për anëtarët</p>	<p>Komisioni nuk ka specifikuar përgjegjësitë specifike për anëtarët e KQZ-ve dhe KVV-ve që vijnë nga</p>

<p>e trupave menaxhues të zgjedhjeve të rekrutuar nga partitë politike duhet të përfshihen në legjislacion (ENEMO)</p>	<p>partitë politike por vetëm ka prekur sipërfaqësisht ato të KKZ-ve. Përgjegjësitë e KVV-ve janë trajtuar më pak. Lënia e detyrave të KKZ-ve dhe KVV-ve për t'u përcaktuar nga KQZ, do të thotë që komisioni ka refuzuar këshillën e ENEMO-s që kjo çështje të rregullohet me ligj.</p> <p>Statusi: E refuzuar pa të drejtë.</p> <p>D4D përkrah rekomandimin e ENEMO-s sepse duhet të rritet përgjegjësia ligjore e individëve në procesin zgjedhor. Në vitin 2010 KQZ lehtësisht i iku përgjegjësisë duke argumentuar se nuk mban përgjegjësi për veprimet e komisionerëve. Kjo gjithashtu argumenton se është me rëndësi se çfarë thotë ligji dhe nuk varet e gjitha tek vullneti aq i përfolur politik.</p>
<p>Kërkohen më shumë detaje në lidhje me rregullat e <u>vendimmarrjes së KQZ-së</u> (p.sh. 2/3 e kuorunit) (ENEMO)</p> <p>Sqarim: ka të bëjë me dy çështje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. sa vota janë 2/3 e KQZ, dhe 	<p>Pas kundërshtimeve të gjata në KQZ, shumica e kualifikuar prej 2/3 është sqaruar. Pas kërkesës së Komisionit për Reformë Zgjedhore drejtuar KQZ-së, kjo e fundit i ka kthyer një përgjigje komisionit se 2/3 e vendimmarrjes është numri 8. Komisioni ka vendosur që kuorumi është 2/3 (interpretuar si 8 anëtarë), dhe vendimmarrja e kualifikuar prej 2/3 gjithashtu interpretohet si 8 anëtarë.</p> <p>Statusi: E sqaruar</p> <p>D4D ka interpretuar që 2/3 interpretohet si 8 anëtarë të KQZ-së dhe mos-interpretimi i duhur më herët ka pasur tendenca politike. Shumica e kualifikuar kërkon votën e së paku 2/3 dhe rrjedhimisht $11 \text{ anëtarë} \times 2/3 = 7.33$ dhe është e natyrshme që të interpretohet si 8.</p>
<ol style="list-style-type: none"> 2. Të sqarohet se për cilat çështje kërkohet vendimi i 2/3 të KQZ 	<p>Sa i përket vendimeve që duhet të merren me 2/3 të votave, KQZ ka propozuar që krahas çështjeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar në ligjin aktual, të shtohen edhe Certifikimi i Rezultateve zgjedhore, Certifikimi i Listës Votuese dhe Miratimi i Rregullores së Punës të KQZ-së.</p> <p>Statusi: E sqaruar dhe propozimet e miratuara</p> <p>D4D në parim përkrah që sa më shumë çështje të votohen me shumicë të kualifikuar, për të parandaluar mbi-votimin e opozitës dhe sfidimin e procesit në momente të ndjeshme.</p>
<p>Izolim i mëtejshëm i sekretariatit të KQZ-së nga presioni politik apo përshtypje për një gjë të tillë (NDI).</p>	<p>Deri vonë ishte kontestues nëse emërimi i kryeshefit të Sekretariatit të KQZ-së (SKQZ) kërkon 2/3 e KQZ-së. Votimi i kësaj çështjeje me shumicë të thjeshtë në KQZ shkaktoi lëshimin protestues të takimit nga opozita. Komisioni vendosi që kryeshefi të emërohet si çdo shërbyes civil dhe jo nga KQZ.</p> <p>Statusi: E përfunduar por nuk siguron pavarësinë e Sekretariatit.</p> <p>D4D mendon që roli i Kryeshefit të SKQZ-së është skajshmërisht i rëndësishëm. Zbatimi i zgjedhjeve varet nga Sekretariati që udhëhiqet nga kryeshefi. Frika nga një kryeshef politik mund të ulë dhe ka ulur besimin në proces nga subjektet në opozitë.</p>

	<p>Kosova duhet të mëtojë që gradualisht të profesionalizojë KQZ-në dhe të ulët roli i anëtarëve politik. Në këtë drejtim, fuqizimi i kryeshefit dhe Sekretariatit duhet të forcohet gradualisht dhe të ketë status të ngjashëm me atë të sekretarëve të përgjithshëm të ministrive si zyrtarët më të lartë të shërbimit civil në një institucion publik. Mirëpo, ekziston frika se nëse emërohet si çdo sekretar i përgjithshëm, mund të jetë politik, ashtu edhe siç janë shumica e sekretarëve. Dëmi nga një kryeshef de facto politik është më i madh, dhe mundësia më e mirë tani është të rritet roli i opozitës në përzgjedhjen e kryeshefit.</p>
--	--

Komisionet komunale të zgjedhjeve dhe Këshillave të vendvotimit

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
<p>Duhet ngritur niveli i <u>profesionalizmit dhe aftësisë të trupave menaxhuese</u> të zgjedhjeve (ENEMO)</p> <p>Kërkohej përmirësim i trajnimit për të siguruar mbrojtje të procesit (ENEMO)</p> <p><u>Anëtarët e KVV-ve</u> duhet të rekrutohen nga radhët e subjekteve politike por të vihen kritere më të larta profesionale dhe këto kërkesa të rregullohen me ligj (ENEMO)</p> <p>Duhet shtuar përpjekjet për trajnimin e zyrtarëve të vendvotimeve për të siguruar masat mbrojtëse dhe zbatimin e tyre kundër praktikave të mashtrimit në zgjedhje dhe shkeljeve më të shpeshta të procedurave zgjedhore si votimit në grup, votimin në emër të dikujt tjetër, falsifikimin e nënshkrimeve në listën e votuesve, mbushjen e kutive të votimit dhe të tjera. Ngjyra e pashlyeshme dhe llambat UV duhet gjithmonë të testohen paraprakisht dhe të sigurohen që të parandalohet manipulimi i tyre.</p>	<p>Duke pasur parasysh që komisionerët paraqesin një nga hallkat më të dobëta të administrimit të zgjedhjeve, Komisioni për Reformë Zgjedhor i ka kushtuar vëmendje të vogël kësaj çështjeje. Komisionerët do të vazhdojnë të caktohen nga partitë politike dhe i vetmi kriter që ata duhet të plotësojnë është që të mund të lexojnë dhe të shkruajnë në një nga gjuhët zyrtare të komunës. Të vetmin ndryshim që komisioni e ka bërë është shtimi i kriterit për shkollim të mesëm.</p> <p>Mënyra diplomatike e formulimit nga ENEMO duhet të merret si rekomandim për të zvogëluar hapësirën për keq-menaxhim. Fakti se listohen këto dukuri tregon se ka probleme në këtë drejtim. Komisioni ka diskutuar por përveç disa konkluzave tejet të përgjithësuara, nuk ka arritur si të trajtojë problemet në fjalë. Përveç shënimit në libër për votim familjar, nuk është marrë asnjë rekomandim serioz tjetër.</p> <p>Se kriteri për shkollim të mesëm nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar brengën e ngritur nga ENEMO tregon rekomandimi i tyre për shtimin e trajnimeve të personave përgjegjës për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.</p> <p>Statusi: E trajtuar por pa rekomandime konkrete</p> <p>D4D beson se pjesa më e madhe e shkeljeve nuk janë bërë për shkak të mungesës së njohurive nga komisionerët por për shkak të motivit dhe mundësisë për keqpërdorim. Sidoqoftë, ngritja e kriterit për shkollë të mesme nuk mjafton as të parandalojë dëmet që rezultojnë nga neglizhenca. D4D rekomandon që anëtarët e KKZ-ve dhe të KVV-ve të kalojnë në trajnim dhe të certifikohen për administrim të zgjedhjeve. Pas certifikimit, secili zyrtar bëhet përgjegjës për keqmenaxhim qoftë të qëllimshëm apo për shkak të neglizhencës.</p>
<p>Të gjenden mënyra për të kufizuar animet partiake në administratën zgjedhore, në</p>	<p>Komisioni e ka diskutuar mundësinë e dislokimit të anëtarëve të KVV-ve por nuk e ka hedhur fare si opsion. Komisioni madje ka propozuar të kundërtën, që gjithsesi komisioneri të jetë nga komuna</p>

<p>veçanti në nivelin e vendvotimeve. Kjo çështje mund të zgjidhet duke paraparë vendosjen e zyrtarëve të zgjedhjeve jashtë komunave të tyre (NDI).</p>	<p>ku është regjistruar si votues. Është pikërisht solidariteti lokal në vende më të vogla ku njohja dhe afërsia kanë mundësuar marrëveshje për keqpërdorim madje edhe përtej ndasive partiake.</p> <p>Statusi: E refuzuar me dëm serioz për procesin zgjedhor.</p> <p>Dislokimi i komisionerëve ka qenë një rekomandim kryesor i Institutit D4D për parandalimin e parregullsive zgjedhore mirëpo kjo fatkeqësisht është refuzuar nga Komisioni parlamentar i cili pas një diskutimi sipërfaqësor e refuzoi me arsyetimin të logjistikës së vështirë.</p>
---	---

Procesi

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
<p>Të organizohen diskutime të gjera dhe transparente duke përfshirë subjektet politike dhe shoqërinë civile sa i përket përdorimit të <u>teknologjisë informative në procesin zgjedhor (NDI)</u>.</p>	<p>Ka pasur diskutime për përdorimin e teknologjisë informative në disa faza të votimit, nga identifikimi biometrik të votuesve, për votim dhe për numërim.</p> <p><u>Identifikimi biometrik.</u> Komisioni ka rekomanduar lexim biometrik për identifikim të votuesve dhe ka parashikuar që programi të rregullohet në mënyrë që të detektojë nëse votuesi është i caktuar për vendvotimin specifik, në mënyrë që mos të varet funksionimi nga lidhja e internetit. Për shkak të pasigurisë nëse diç e tillë do të funksionojë si duhet, rekomandimi përfundimtar në draft-ligj mbeti që të lihet edhe opsioni klasik si i mundshëm. KQZ-së i lihet në diskrecion që të zgjedhë se cilin sistem ta përdor.</p> <p><u>Votim.</u> Disa projekte kanë paraqitur opsione për votim elektronik që marrin parasysh edhe konditat kosovare të mungesës së rrymës apo probleme të ngjashme. Asnjë nga ta nuk është pranuar.</p> <p>Statusi: E papërfunduar. Rekomandimet janë shqyrtuar, por gjasat që ndonjë nga opsionet të përdoren janë minimale.</p> <p>Ekspertët ndërkombëtarë kanë theksuar vështirësi dhe rezerva në zbatimin e këtij sistemi dhe mund të jetë i domosdoshëm ruajtja e një sistemi rezervë tradicional, gjë që sërish e hap sistemin ndaj keqpërdorimeve.</p>
<p>Duhet të qartësohet neni 90 i Ligjit për zgjedhje të përgjithshme për <u>dokumentet e vlefshme të identifikimit (ENEMO)</u></p>	<p>Komisioni nuk ka qenë në gjendje të vendos përfundimisht për përdorimin vetëm të dokumenteve të Republikës së Kosovës për identifikim gjatë zgjedhjeve. Është kërkuar interpretimi i Zyrës Civile Ndërkombëtare ZCN-së për të shikuar se a do të mund të kufizohej votimi vetëm me dokumente të Republikës së Kosovës.</p> <p>Statusi: E papërfunduar</p> <p>D4D e sheh këtë çështje si të ndjeshme dhe mund të përjashtojë shumë persona të zhvendosur nga procesi i votimit në të cilin kanë të drejtë themelore që parashihet me kushtetutë. Duhet të hiqet e</p>

	drejta e votimit me dokumente të UNMIK-ut por të ruhet validiteti i kartelave të refugjatit dhe të personave të zhvendosur.
Duhet konsideruar përfundimin e praktikës së Votimi me Kusht (NDI)	<p>Komisioni parlamentar ka rekomanduar që të hiqet votimi me kusht dhe ky paraqet lajm të mirë. Mirëpo, ndryshimet që janë propozuar për riparimin e listës zgjedhore nuk japin besim që adresat dhe p-kodet në listë të votuesve do të përmirësohen ndjeshëm, gjë që mund të kthejë votimin me kusht si opsion i vetëm për të mos shkelur të drejtën e votës. Mënjanimi i opsionit të votimit me kusht nga ligji është pozitiv sepse obligon MPB dhe KQZ që të jenë të saktë dhe të shpejtë në azhurnimin e adresave.</p> <p>Statusi: E trajtuar në parim, por kërkon mobilizim shtesë.</p>

Numërimi

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
<p><u>Numërimi i votave</u> në lokacionet qendrore p.sh në nivel zonal, mund të lehtësojë numërimin dhe të përmirësojë vëzhgimin e numërimit, por gjithashtu mund të krijojë ndërlikime rreth mirëmbajtjes së integritetit të materialeve gjatë transportit (NDI)</p>	<p>Rekomandimi për numërimin e votave në qendra rajonale është dhënë nga Komisioni për reformë zgjedhore pikërisht me arsyetimin se ky numërim lehtëson mbikëqyrjen e numërimit. Duhet pasur parasysh se numërimi në qendra të numërimit rajonale shton edhe transportin e materialeve zgjedhore që krijon hapësirë shtesë për keqpërdorime nëse edhe ky transport nuk është i monitoruar mirë. Komisioni ka lënë dy opsione, për numërim në vendvotim dhe për numërim të centralizuar në disa qendra rajonale.</p> <p>Statusi: E papërfunduar.</p> <p>Është e qartë se ky diskutim nuk mund të përfundohet pa përfundimin e diskutimit për zona zgjedhore.</p>
<p><u>Përdorimi i skanerëve</u> për fletëvotime mund të thjeshtësojë sigurinë e numërimit dhe gjithashtu mundëson verifikimin e tyre (ENEMO)</p>	<p>Është propozuar përdorimi i skanerëve për numërim, veçanërisht nëse centralizohet numërimi në një apo disa qendra rajonale. Kjo mundësi është diskutuar dhe komisioni ka rekomanduar të shqyrtohet përdorimi i skanerëve, por ky rekomandim nuk është përfshirë në amendamentet e hartuara.</p> <p>Statusi: E papërfunduar</p> <p>Kjo çështje duhet të diskutohet më në detaje dhe përdorimi i skanerëve të jetë pjesë e numërimit në zgjedhjet e ardhshme sepse një gjë e tillë mund të rrisë besimin dhe transparencën në zgjedhje. Nëse shkohet me sistem të centralizuar, mund të shqyrtohen kamerat. Kostoja e skanerëve i bën që ky opsion të ketë kuptim vetëm në rast të numërimit të centralizuar.</p>

Ankesat, Parashtresat dhe Sanksionet

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
Mundësia që <u>KQZ</u> -ja të ketë kompetenca <u>mbi vendimet e PZAP-it</u> mund të vështirësojë zgjidhjeve të papajtueshmërive zgjedhore (EU EEM)	Amendamentet e ligjit të ri shkojnë në favor të përmirësimit të kësaj situatë. Në të ardhmen parashihet që KQZ të zbatojë vendimet e PZAP-së pa diskutim. Statusi: E trajtuar
Mund të merret në konsiderim zgjatja e periudhës së paraqitjes së <u>ankesave apo parashtresave</u> në afat prej 24 deri në 48 orë (EU EEM, NDI)	Koha e pranimit të ankesave dhe parashtresave është rekomanduar që të zgjatet në 48 orë, dhe pritjet të votohet si e tillë. Statusi: E trajtuar
Të eliminohet çdo mundësi e ndëshkimit kolektiv (EU EEM)	Komisioni parlamentar ka rekomanduar që të hiqen dënimet kolektive për subjektet politike kur gjenden parregullsi dhe vandalizëm gjatë fushatës zgjedhore. Dënimi kolektiv është ruajtur vetëm për mos largim të posterëve. Përkundër kundërshtimeve nga PZAP dhe nga Vetëvendosja, ky rekomandim ka kaluar. Statusi: E trajtuar , por kjo paraqet degradim të procesit zgjedhor në Kosovë. Kjo mund të shpie deri tek situata kur subjektet politike nuk do të kenë më asnjë dënim për shkelje në fushatë. Instituti D4D e vlerëson se ky vendim paraqet degradim pasi që subjektet politike nuk do të bëjnë përpjekje për të dekurajuar simpatizantët e tyre për të mos dëmtuar materialet zgjedhore të partive tjera e madje mund t'i inkurajojnë ata. Kjo vlen veçanërisht për shkak se barra e dëshmisë vihet për secilin individ gjë që PZAP nuk do të ketë resurse dhe mundësi për të hetuar. Ngjashëm si në ngjarje sportive ku klubet dënohen për sjelljet e tifozëve, D4D preferon që këto dënime të mbeten sepse përndryshe mund të sjellë keqpërdorime dhe dhunë gjatë fushatës.
Legjislacioni duhet të udhëzojë gjykatat dhe të sigurojë se <u>vendimet e tyre në këtë drejtim janë proporcionale me shkeljet e kryera</u> , në pajtim me kushtetutën dhe me kodin penal (EU EEM)	Komisioni e ka anashkaluar tërësisht këtë pikë duke mos dhënë asnjë rekomandim apo udhëzim që gjykatat të sigurojnë vendime në proporcion me shkeljet e kryera. Komisioni nuk është marrë me këtë pikë me arsyetimin se kjo do të ishte ndërhyrje në gjyqësor. Statusi: E patrajtuar Duhet të kërkohet interpretim ligjor nëse këto sqarime duhet të përfshihen në Ligjin e zgjedhjeve apo të kërkohet ndërhyrje në Kodin penal për udhëzimet më detale të mëtutjeshme. Më konkretisht, duhet t'i hiqet mundësia që i ipet PZAP-it të ndalojë nga garimi një kandidat për shkak të mospagesës së gjobës nga PZAP.

<p>Ligji nuk përcakton <u>sanksione për subjektet politike</u> të cilat i paguajnë gjambat me vonesë (ENEMO)</p>	<p>Është rekomanduar që të hiqet dënimi shtesë por të rritet kamata mujore për shtatë përqind (7%) të dënimit bazë deri në kryerjen e pagesës për ato subjekte që nuk paguajnë dënimet me kohë. Kamata është pozitive por duhet pasur parasysh se kamata ka qenë e paraparë me rregullat e OSBE-së për zgjedhjet e mëhershme dhe zakonisht është hequr apo zbutur për shkak se pak subjekte e kanë paguar atë.</p> <p>Statusi: E trajtuar pjesërisht</p> <p>D4D insiston që dënimet të jenë më rigoroze dhe me afat të pagesës së shpejtë pas përfundimit të zgjedhjeve.</p>
--	---

Regjistrimi i partive dhe lista e votuesve

Komentet dhe sugjerimet	Vlerësimi i D4D-së mbi adresimin e këtyre propozimeve nga Komisioni Parlamentar
<p>Të konsiderohet hartimi i një ligji të veçantë për <u>regjistrimin dhe veprimin e subjekteve politike</u> dhe të kandidatëve (ENEMO)</p>	<p>KQZ administron shumicën e aspekteve të regjistrimit të partive politike dhe kandidatëve, dhe deklaratimet financiare të tyre. Si në praktikën e tanishme, Komisioni i lë KQZ-së përgjegjësinë për regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike që konsiderohet konflikt i interesit pasi që KQZ është e përbërë nga partitë politike dhe gjithashtu regjistron partitë e reja. Komisioni nuk e ka shqyrtuar fare mundësinë për hartimin e një ligji të veçantë për regjistrimin e partive politike. Kosova akoma mbetet pa një ligj për partitë politike që ndikon negativisht në infrastrukturën ligjore për zgjedhje.</p> <p>Statusi: E patrajtuar</p> <p>D4D konsideron se duhet të hartohet një ligj i ri për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike.</p>
<p><u>Periudha e Shërbimit të votuesve</u> është tejet e shkurtë (EU EEM)</p>	<p>Komisioni ka rekomanduar zgjatjen e shërbimit të votuesve në dy muaj mirëpo kjo bie ndesh me rekomandimet e Komisionit të Venedikut që parasheh transparencë të listave gjatë gjithë kohës. Vazhdimi që kjo periudhë të jetë 2 muaj është përparim modest krahasuar me më herët por nuk adreson praktikën ndërkombëtare.</p> <p>Statusi: E trajtuar pamjaftueshëm</p> <p>Duke marrë parasysh problemet serioze që Kosova ka me listë të votuesve, duhet të parashihet që të dhënat relevante nga regjistri civil të jenë transparente gjatë gjithë kohës.</p>

Përfundimet dhe sugjerimet

Mandati i komisionit për reformë zgjedhore ka hyrë në muajin e fundit dhe drafti i parë i ligjit pritet të përfundohet së shpejti nga grupi draftues. Drafti trajton një pjesë tejet të vogël të problemeve që kanë përcjellë zgjedhjet kosovare. Komisioni nuk duhet të përfundojë punën pa adresuar shumicën e problemeve kryesore, dhe pa mbyllur zbrazëtitë ligjore për manipulime.

D4D insiston që komisioni të rishqyrtojë edhe njëherë rekomandimet dhe të sjellë vendime që mund të jenë të vështira por që janë e vetmja shpresë për të rikthyer besimin në zgjedhje. Dëshira për të përmbyllur punën me afat është e kuptueshme. Por tani që dihet se nuk do të ketë zgjedhje këtë vjeshtë, kjo kohë duhet të shfrytëzohet maksimalisht për reforma të mirëfillta. Pas vendimit për zgjedhje të drejtpërdrejta për President, Kosova rrallëherë do të ketë luksin e viteve pa zgjedhje dhe kjo duhet të shfrytëzohet për reforma rrënjësore.

Opozita ka interes që të parandalohen shkeljet dhe duhet të insistojë në vazhdimin e mandatit për reformë. Afati për zgjedhjet e të përgjithshme për vjeshtën e vitit 2013 mund të ruhet vetëm nëse këto zgjedhje nuk ndodhin afër me ato lokale.

Vendimi për çështjen e sistemit zgjedhor (zonat, pragun, listat) duhet të merret sa më shpejtë. Tendanca për mbylljen e listave paraqet degradim dhe duhet të luftohet. Ky vendim ndikon drejtpërdrejtë në rregullimin e procesit zgjedhor dhe vonesat tij vështirësojnë parandalimin e keqpërdorimeve.

Duhet ndryshuar qasja sipërfaqësore ndaj shkeljeve. Një rishikimi i mirëfilltë duhet të përfshijë edhe Kodin penal. Legjislacioni duhet të obligojë gjykatat të trajtojnë shkeljet zgjedhore me prioritet dhe që manipuluesit e votave të marrin dënimin e merituar në proporcion me shkeljet dhe kjo mos t'i lihet gjykatësit diskrecion i tepruar. Një qasje e tillë sistematike duhet të krijojë pajtueshmëri dhe të rikthejë ndjenjën se zgjedhjet tona janë të vlefshme dhe se ato duhet ruajtur nga keqpërdorimet.

Duhet të shqyrtohet hartimi i një Kodi gjithëpërfshirës zgjedhor që i qaset reformës në mënyrë rrënjësore dhe siguron konsistencë. Duhet t'i iket arsyetimeve demagogjike se mungon vullneti politik dhe se përmbajtja e ligjit nuk çon peshë. Duhet treguar përkushtim që ligji i ri të jetë rigoroz dhe të zvogëlojë vakuumin ligjor që mundëson shkeljet pa u dënuar.